


RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

FURNIZIM ME MATERIAL SHPENZUES PËR HEMODIALIZË

MARS 2019



RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK NË MINISTRINË E SHËNDETËSISË

**FURNIZIM ME MATERIAL
SHPENZUES PËR HEMODIALIZË**

MARS 2019

COPYRIGHT © 2019.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Autor: Liridona Behrami

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	6
HYRJE	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
METODOLOGJIA.....	12
TRANSPARENCA	13
ANALIZA E KONTRATAVE.....	14
1. FAZA TENDEUESE	14
2. TENDERIMI	18
3. VLERËSIMI DHE DHËNIA E KONTRATËS	18
KONTRATA ME PROCEDURË TË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË ME NUMËR TË PROKURIMIT 206-18-6370-115.....	20
1. FAZA PARATENDEUESE.....	20
2. TENDERIMI	21
3. VLERËSIMI DHE DHËNIA E KONTRATËS	22
KONTRATA ME PROCEDURË TË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË ME NUMËR PROKURIMI 206-18-8748-115.....	23
1. FAZA PARATENDEUESE.....	23
2. TENDERIMI	23
3. VLERËSIMI DHE DHËNIA E KONTRATËS	23
KONKLuzionET.....	25
REKOMANDIME	26



LISTA E SHKURTESAVE

AK	Autoriteti Kontraktues
BE	Bashkimi European
DT	Dosja e Tenderit
FSSh	Fondi i Sigurimit Shëndetësor
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LEB	Lista Esenciale e Barnave
LOT	Një numër njësisish të një artikulli, një artikull të vetëm, ose një paketë artikujsh të ofruara si një artikull
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
MSh	Ministria e Shëndetësisë
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OE	Operatori Ekonomik
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
TI	TransparencyInternational
UA	Udhëzim Administrativ
ZP	Zyrtar i Prokurimit



HYRJE

Shëndetësia konsiderohet një nga shërbimet më të rëndësishme publike për qytetarët. Sot, qytetari i Kosovës, pavarësisht se paguan tatime në nivele të ndryshme, në mungesë të shërbimit shëndetësor publik, duhet të paguajë nga xhepi i tij barnat dhe shërbime private shëndetësore. Kjo e rritë nevojën për menaxhim më të mirë, reformim dhe mbikqyrje të këtij sektori.

Në vitin 2018, nga buxheti i shtetit prej 2.08 Miliardë Euro, vetëm 3% (ose 65.5 Milion Euro) ishin ndarë për të gjitha shpenzimet shëndetësore, përfshirë këtu edhe furnizimin me barna¹. Kjo politikë përveç që është e disfavorshme, konsiderohet edhe paradoksale, për faktin se qytetarët e Kosovës kanë jetëgjatësinë më të shkurtër në rajon, me një mesatare prej 71 vite (krahasuar me atë të Shqipërisë - 78, Bosnjës - 77, Maqedonisë - 76 dhe Serbisë - 75)². Shto këtu edhe numrin në rritje të vazhdueshme të qytetarëve të prekur nga sëmundjet e rënda për shkak të faktorëve jetësor si ushqimi dhe ajri³.

Për gati 20 vite, ky sektor parësor për mirëqenien e qytetarëve, ka qenë i përfolur për keqpërdorime të shumëta dhe monopole në furnizime me barna dhe material shpenzues nën pretekstin e patentave dhe aparaturës së pranuar në emër të donacioneve⁴. Një gjë e tillë, ishte mëse e theksuar edhe në sektorin e hemodializës, ku furnizimi me material shpenzues është bërë nga i njëjti Operator Ekonomik, me një çmim jo-normalisht të lartë dhe duke shfrytëzuar procedurat e mbyllura nën arsyetimin se aparatura në shfrytëzim nuk përkrahë opzione të tjera⁵.

PËR PËRPILIMIN E KËTIJ RAPORTI, KDI ka analizuar mbi 50 dokumente dhe publikime, me mbi 300 faqe, ka pasur dhjetëra takime dhe biseda telefonike, dhjetëra komunikime përmes postës elektronike, ka organizuar një fokus grup me akter të fushës, ka parashtruar 2 kërkesa për qasje në dokumente publike, etj.

Megjithatë, në vitin 2018, Ministria e Shëndetësisë kishte filluar disa iniciativa, me qëllimin e përmirësimit të këtyre problemeve të sipërcekura. Në prill 2018, MSH kishte filluar procedurat e përpilimit të legjislacionit dytësor, i cili adresonte tavanet e çmimeve të barnave⁶, revidimin e Listës Esenciale të Barnave⁷, si dhe mundësitë e hapjes së tenderëve, të cilët historikisht ishin zhvilluar me procedura të mbyllura një burimore, si dhe kishte inicuar procedura ndëshkimore për konflikt të interesit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare brenda ministrisë⁸.

1 Ligji Nr. 06/L-020 Për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, fq. 18, i qasshëm në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

2 Banka Botërore, "Treguesit e Zhvillimit Botëror". I qasshëm në: <https://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.LE00.IN?locations=XK&view=chart>

3 Rritet numri i të prekurve nga kanceri, onkologët gjejnë shkaktarë ushqimin e ajrin, KOHA , 27 maj 2018, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/95681/rritet-numri-i-te-prekurve-nga-kanceri-onkologet-gjejne-shkaktare-ushqimin-e-ajrin/>; Në Kosovë rritet numri i personave të sëmurë nga veshkat, KOHA 9 mars 2017, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/4624/ne-kosove-rritet-numri-i-personave-te-semure-nga-veshkat/>

4 Milionat që u keqpërdorën me barna të shtrenjta, Gazeta Zëri, 18 tetor 2018; e qasshme në: <https://zeri.info/ekonomia/221433/milionat-qe-u-keqperdoren-me-barnat-e-shtrenjta/>

5 Ministria e Shëndetësisë shkel ligjin në tenderin milionësh, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/73328/ministria-e-shendetesise-shkel-ligjin-ne-tenderin-milionesh/>

6 DRAFT Udhësuesi Administrativ i datës 02 maj 2018 i qasshëm në : <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40359>

7 Procedurat e filluara me datën 06 gusht 2018

8 MSH-ja pezullon zyrtarët e arrestuar për keqpërdorim të mbi 1 milion eurove, më 16 nëntor 2018, i qasshëm në: <https://www.koha.net/arberi/129274/msh-ja-pezullon-zyrtaret-e-arrestuar-per-keqperdorim-te-mbi-1-milion-eurove/>



Me qëllim të matjes së suksesit dhe pasqyrim të sfidave të këtyre iniciativave për reforma në Ministri të Shëndetësisë, KDI ka përzgjedhur për trajtim në këtë raport, tenderin për furnizim me material shpenzues për Hemodializë.

Ky raport analizon procedurat e shfrytëzuara për këtë furnizim, me qëllim të vlerësimit të përmbushjes së parimeve bazë të prokurimit publik, të shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore⁹.

⁹ Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 1, Qëllimi



PËRMBLEDHJE

EKZEKUTIVE

Në Kosovë, çdo vit, ka mbi 800 pacientë¹⁰ të cilët trajtohen në repartin e Hemodializës, dhe rëndësinë e kësaj procedure, e cila kryhet tek pacientët veshka e të cilëve ka dalë përkohësisht ose përgjithmonë jashtë funksionit¹¹. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij shërbimi, koston, monopolin në furnizim me material shpenzues, për më shumë se një dekadë dhe herën e parë që tenderi për këtë furnizim është hapur për tregun, raporti në vijim pasqyron benefitet dhe sfidat në këtë furnizim, për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2018.

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në procesin e prokurimit publik në Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), KDI në tetor 2018, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion për të mundësuar shkëmbimin e informatave dhe praktikave të mira që do t'i kontribuonin avansimit të procesit të prokurimit publik.

Në këtë raport janë analizuar tre Kontrata Publike, lidhur me furnizimin me material shpenzues për Hemodializë, të cilat ishin zhvilluar gjatë vitit 2018. Për kontratat e analizuara, Ministria e Shëndetësisë kishte shfrytëzuar një procedurë të hapur¹² dhe dy me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë¹³.

Kontrata publike kornizë me procedurë të hapur¹⁴ ishte karakterizuar me vonesa të shumta deri te dhënia e kontratave për të gjitha Lot-et. Edhe pse njoftimi për kontratë ishte shpallur me datë 19 prill 2018, për shkak të ankesave të Operatorëve Ekonomik¹⁵ në OSHP¹⁶, njoftimi i fundit për nënshkrim të kontratës kishte ndodhur me 13 dhjetor 2018.¹⁷

Si pasojë e vonesave në dhënien e kontratës për furnizim me material shpenzues për Hemodializë, Ministria e Shëndetësisë, për të përmbushur nevojat e repartit të Hemodializës, kishte lidhur dy Kontrata¹⁸ me procedurë të negociuar pa publikim¹⁹. Vlera totale për këto furnizime ishte 1,449,307.00 Euro, nga e cila 1,060,620.00 Euro ishte vlera e kontratave të nënshkruara për tenderin me procedurë të hapur dhe 388,687.00 për furnizimet me procedura të mbyllura²⁰ (206-18-6370-115 dhe 206-18-8748-115).

Gjatë analizimit të këtyre kontratave, KDI kishte gjetur se, me vendim të OSHP-së²¹, për herë të parë pas më shumë se një dekade, furnizimi me material shpenzues për Hemodializë, po zhvillohej me procedura të hapura. Ky ishte një hap pozitiv në përmbushjen e parimeve të ligjit për prokurim publik²².

10 Informatë e pranuar nga MSH me datën 21 nëntor 2018

11 Spitali Acibadem SISTINA: "Çfarë është dializa?", e qasshme në: <https://acibademсистина.mk/health/al/index.php/urologija-bubrezi/352-cfare-esh-te-dializa.html>

12 Tenderi me numër të prokurimit: 206-18-2512-111 (data 19.04.2018)

13 Tenderët me numra të prokurimit: 206-18-6370-115 (data 03 shtator 2018) dhe 206-18-8748-115 (data 12 nëntor 2018)

14 Tenderi me numër të prokurimit: 206-18-2512-111

15 Ankesat e Operatorëve Ekonomik (OE) ishin në lidhje me kriteret dhe specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit (DT) nga MSH dhe vendimet e MSH për dhënie të kontratave. Mospërgatitja e duhur e specifikimeve teknike kishte rezultuar me pakënaqësi tek OE i cili kishte deponuar ankesë në OSHP lidhur me specifikat në DT.

16 Vendimi i OSHP-së, numër 348/18 i datës 17 gusht 2018 dhe vendimi me numër 581/18,606/18, i datës 23 nëntor 2018

17 Njoftimi për nënshkrimin e kontratës, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=311438

18 Njoftimi për dhënie të kontratës: https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=231506 dhe https://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=288224

19 Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 35 .2.1 (iii)

20 284,040.00€ vlera e kontratës 206-18-6370-115 data 03.09 2018 dhe; 104,607.00€ vlera e kontratës 206-18-8748-115 data 12.11.2018

21 Vendimi i OSHP-së numër 504/17, i datës 02.02.2018

22 Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (parimet)

MSH kishte filluar procedurat tenderuese rreth dy muaj para skadimit të kontratës ekzistuese për këtë furnizim. Duke marr parasysh afatet kohore të obligueshme me ligj për zhvillimin e këtyre procedurave, koha e paraparë për iniciimin e prokurimit nuk ishte e mjaftueshme²³. Procesi i tenderimit dhe dhënies së kësaj kontrate kishte zgjatur tetë muaj, respektivisht nga 19 prill 2018 deri më 13 dhjetor 2018. Nga tenderi në fjalë kishin rezultuar dy kontrata me ç'rast Kontrata e parë²⁴ ishte për furnizim me material shpenzues për Hemodializë me produktet koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit, koncentrat i lëngshëm acidik dhe linjat A-V, në vlerë prej 284,040.00 € dhe ishte nënshkruar me datën 3 shtator 2018, dhe kontrata e dytë²⁵ ishte për furnizim me material shpenzues për Hemodializë me produktet koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit dhe linjat A-V, në vlerë prej 104,607.00 € dhe ishte nënshkruar më 12 nëntor 2018. Kjo procedurë e hapur kishte rezultuar edhe në shtimin e dy produkteve të reja, koncentratet e të njëjtëve komponentë por në gjendje të lëngshme (koncentrat bikarbonati dhe acidik), të cilat sipas zyrës për cilësi të Qendrave të Hemodializës në Kosovë²⁶ janë pranuar pa probleme nga aparatura në shfrytëzim. Futja e këtyre dy produkteve në përdorim, ka rezultuar në një kursim në çmim, prej mesatarisht 64% për koncentrat bikarboni, linjat A-V dhe Tretesirën Dezinfektuese, ndërsa 97% në çmimin për furnizim me koncentrat acidik.

Kontrata e parë emergjente²⁷ ishte ballafaquar me disa sfida në vete. Edhe pse kishte lindur si nevojë për të përmbushur nevojat emergjente të repartit të Hemodializës për trajtimin e pacientëve me diabet, procedura për dhënien e kësaj kontrate nuk kishte shterur të gjitha mundësitë që ofron ligji për prokurim publik, për të arritur efikasitetin dhe ekonomicitetin e shfrytëzimit të parasë publike përmes këtyre procedurave. Për shkak të vonesave në procedurën e hapur si rrjedhojë e ankesave të OE lidhur me specifikat e tenderit²⁸, afati për hapjen e ofertave ishte përcaktuar për datën 03 shtator 2018. Kontrata e parë e negociuar pa publikim²⁹, ishte nënshkruar me datën 03 shtator 2018. Kjo kontratë ishte nënshkruar me një OE të ri në tregun publik për furnizim me koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit, koncentrat i lëngshëm acidik dhe linjat A-V. Ligji për prokurim publik, për procedurat emergjente³⁰ parasheh mundësinë që Autoriteti Kontraktues të negocioj me një apo më shumë operator ekonomik³¹. Meqë, ofertat e pranuar në përgjigje të procedurës së hapur nuk ishin hapur deri më datën 07 shtator 2018, nga dokumentet e pranuar nga MSH, KDI nuk ka arritur të dëshmojë njohurinë e MSH-së lidhur me kapacitetet realizuese dhe kualifikimet e një OE të ri në furnizimin me produktet e sipërcekura, dhe arsyet për përjashtimin e OE performues nga kjo procedurë. Pa marrë parasysh sfidat e mësipërme, për shkak të iniciativave për thyerjen e monopolit në furnizim me material shpenzues për hemodializë, kjo kontratë qytetarit i ka kursyer mesatarisht 36% të çmimeve për njësi të paguara historikisht për koncentrat të bikarbonit dhe linjat A-V, dhe rreth 95% për furnizim me koncentrat acidik.

Gjithashtu, në mungesë të njohurive për çmimet e ofertuara në përgjigje të procedurës së hapur, MSH kishte shfrytëzuar si bazë të negociimit çmimet e kontratës paraprake (kontratë kjo e lidhur me OE i cili për më shumë se dhjetë vite ka furnizuar repartin e Hemodializës me këto produkte), e që pas analizimit të çmimeve, KDI ka vërejtur se çmimet e kontraktuara në kontratën emergjente ishin deri në 209% (229,039.60€) më të larta se çmimet me të cilat kishte ofertuar OE i njëjtë në procedurën e hapur vetëm tre muaj më vonë.

23 Afatet për procedurat e tenderimit në bazë të vlerave dhe ankesave të mundëshme, shih faqe 21, tabela e afateve ligjore.

24 Kontrata me numër: 206-18-6370-115

25 Kontrata me numër: 206-18-8748-115

26 Dokemnt i pranuar nga MSH: Komunikim përmes e-mailit i datës 05 shtator 2018 nga koordinatori nacional për cilësi të Qendrave të Hemodializës së Kosovës.

27 Kontrata numër: 206-18-6370-115

28 Tenderi me numër prokurimi: 206-18-2512-111 (procedura e hapur)

29 Kontrata me numër: 206-18-6370-115

30 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 35.2.1 (iii)

31 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 50 Rastet e emergjencës ekstreme: 50.2 Për rastet e emergjencës ekstreme – ekziston mundësia të përdoret procedura e negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës, neni 35.2.1 (iii) i LPP-së. Kjo procedurë mund të zhvillohet me një ose më shumë operatorë ekonomik të zgjedhur nga autoriteti kontraktues. Nuk ka afate minimale kohore që lidhen me kryerjen e kësaj procedure.

|||||

Tutje, edhe pse tenderi ishte i ndarë në tre Lot-e, këto Lot-e ishin përfshirë si tre komponentë të një kontrate të vetme, ku sipas legjislacionit për rregullimin e prokurimit publik, vlera e tërësishme e të gjitha Lote-ve është vlera e parashikuar e kontratës³². Duke u bazuar në këtë përkufizim ligjor, sipas të njëjtit legjislacion, Ministria e Shëndetësisë nuk është dashur të trajtoj vlerën e kontratës si vlerë të ndarë sipas parashikimeve për Lot³³; me ç'rast kjo kontratë është dashur të nënshkruhet edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ³⁴, i autorizuar për nënshkrimin e kontratave të vlerës së madhe³⁵, dhe jo vetëm nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit³⁶.

Për sa i përket kontratës së dytë emergjente³⁷, nevoja për të gjithashtu kishte lindur për shkak të vonesave në adresimin e ankesave dhe vendimin e OSHP-së në tenderin me procedurë të hapur³⁸. Kjo kontratë për furnizim emergjent me material shpenzues medicinal për Hemodializë nga Lista Esenciale e Barnave, përmbante dy Lot-e, ishte dhënë në muajin nëntor 2018. Me këtë rast MSH kishte kërkuar shprehje të interesit nga gjashtë kompani, por që për shkak të afateve të shkurta për përgatitje³⁹, kishte pranuar përgjigje vetëm nga OE performues i kontratës së parë emergjente. Gjithashtu, çmimet e kontraktuara për dy Lot-et e kësaj kontrate ishin 12% më të lira se çmimet për produktet e njëjta nga kontrata paraprake emergjente, edhe pse ishte i njëjti operator ekonomik për sasi dhe afate të përafërta.

- 32 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.9: Nëse aktiviteti i prokurimit ndahet në disa lote, dhe secila i nënshtrohet kontratës së veçantë, vlera e tërësishme e parashikuar për të gjitha lotet e tilla do të jetë "vlera e parashikuar e kontratës".
- 33 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.4..." Sidoqoftë, ndarja në lote nuk nënkupton ndarjen e vlerës së kontratës ose shmangien nga pragjet e vlerave, pasi që përbëhet nga vlera e përbashkët e loteve".
- 34 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 9. Funksionet e Zyrtarit Kryesor Administrativ; paragrafi 9.1.h. *Për të nënshkruar kontratat me vlerë të madhe (nga kjo përgjegjësi përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri si dhe Ministri i Financave kur Qeveria ose Ministria e Financave cakton AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit konform nenit 95 të LPP-se);*
- 35 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.14 Pragjet e vendosura për aktivitetet të ndryshme të prokurimit janë si në vijim: Nga tabela: Furnizim – Vlerë e madhe \geq 125,000 €. Vlera e përgjithshme e kontratës 206-18-6370-115 është 284,040.00€
- 36 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 26, paragrafi 2: "përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha (mbi 125.000 mijë euro) të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik.
- 37 Kontrata numër, 206-18-8748-115; data 12.11.2018
- 38 Tenderi me numër: 206-18-2512-111
- 39 Gjatë intervistimit të datës 29 nëntor dhe 7 dhjetor 2018, të OE të thirrur nga MSH për tenderim në këtë procedurë, përgjigja e pranuar pse nuk kishin ofertuar për këtë procedurë ishte se nuk kishin kohë të mjaftueshme për përgatitjen e ofertës dhe afatit shumë të shkurtë për liferimin e produkteve të kërkuara nga MSH-ja që të bëhet brenda 24 orëve.

|||||



METODOLOGJIA

Për përpilimin e këtij raporti janë përdorur analiza kuantitative dhe kualitative me qëllim të pasqyrit të një situatë sa më korrekte lidhur me aktivitetet e prokurimit për furnizim me material shpenzues për Hemodializë në MSH. Ky hulumtim tenton të masë zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik nga MSH, përmes ekzaminimit të procesit të dhënies së kontratave për Furnizim me material shpenzues medicinal për Hemodializë për vitin 2018.

Varësisht se në cilën fazë të prokurimit kanë qenë kontratat në kohën kur është kryer hulumtimi, në përgjithësi në secilën nga kontratat e përzgjedhura janë analizuar fazat e prokurimit që nga vlerësimi i nevojave dhe planifikimi, përgatitja e specifikacioneve teknike, vlerësimi i ofertave, dhe dhënia e kontratës. Përveç kësaj është analizuar edhe niveli i transparencës, proporcionalitetit, trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi i Operatorëve Ekonomik, si dhe ankesat e deponuara në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) dhe vendimet e marrura nga ky organ.

Kjo metodologji e hulumtimit dhe monitorimit në prokurimin publik është bazuar në udhërrëfyesin dhe praktikën e organizatave – degë të Transparency International nëpër shtete të ndryshme.



TRANSPARENCA

Me datën 03 tetor 2018, Ministri i Shëndetësisë, z.Uran Ismajli kishte nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me KDI, ku ishte zotuar për transparencë dhe bashkëpunim gjatë monitorimit të procesit të prokurimit publik në këtë institucion.

Deri më 11 dhjetor 2018, lidhur me kontratat në fjalë, KDI ka dërguar dy kërkesa për qasje në dokumente publike, një në divizionin e prokurimit dhe një në SHSKUK.

Në të dy rastet KDI ka pranuar të gjitha dokumentet e kërkuara dhe atë brenda afatit ligjor prej shtatë ditësh⁴⁰. Një numër i madh i dokumenteve janë marrë nga ueb faqja zyrtare e Ministrisë së Shëndetësisë dhe platforma e-prokurimi. Pyetjeve të shumta të KDI-së, zyrtarët e MSH-së i'u kanë përgjigjur përmes e-mailit, telefonit si dhe në takimet e realizuara me ta.

Me datën 03 shtator 2018, ndryshimi në legjislacionin për prokurim publik⁴¹ ka bërë të obligueshëm publikimin e kontratave për të gjitha Autoritetet Kontraktuese në platformën e eProkurimit. Gjatë analizës së kontratave të përzgjedhura për këtë raport, KDI kishte gjetur se kontratat e dhëna në përgjigje të tenderit me procedurë të hapur⁴² si dhe kontrata e parë e negociuar pa publikim⁴³ nuk ishin publikuar në eProkurim dy ditë pas nënshkrimit të tyre⁴⁴. Me ngritjen e këtij shqetësimi nga KDI, Ministria e Shëndetësisë me datën 19 shkurt 2019⁴⁵, i ka publikuar këto kontrata.

⁴⁰ Ligji nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>)

⁴¹ A01 NDRYSHIM/PLOTESIM i Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, 03.09.2018, Neni 22, paragrafi f. Njoftim për nënshkrim të kontratës, pika 4: · Përpos Njoftimit për nënshkrim të kontratës, AK duhet që të publikojë kontratën e nënshkruar. Publikimi behët në platformën e prokurimit elektronik, si dokument shtesë nëpërmjet funksionit "shtoni dokument te ri". Termi kontratë i referohet Kontratës, Kushteve të Përgjithshme të Kontratës, Kushteve të Veçanta të Kontratës, dhe Listës së Çmimeve.

⁴² Kontrata me numër të prokurimit: 206-18-2512-111, kontrata për Lot 5 dhe kontrata për Lot 1,2,3,4 dhe 6

⁴³ Kontrata me numër të prokurimit: 206-18-6370-115

⁴⁴ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 22, Publikimet; paragrafi f. Njoftim për nënshkrim të kontratës pika 1: Nëse një AK ka nënshkruar një kontrate publike duke përdorur procedurën e hapur, kufizuar, konkurruese me negociata, negociuar pa publikim, kuotim të çmimit ose me vlerë minimale, brenda 2 ditë, pas nënshkrimit, ZP do të përgatis Njoftimin për nënshkrim të kontratës pavarësisht nga lloji apo vlera e parashikuar.

⁴⁵ eProkurimi: http://e-prokurimi.rks-gov.net/SPIN_PROD/APPLICATION/IPN/DocumentManagement/DokumentPodaciFrm.aspx?id=143179;



ANALIZA E KONTRATAVE

1. FAZA PARATENDERUESE

a. PLANIFIKIMI

Me datën 20 dhjetor 2017, MSH kishte nëshkruar kontratën me procedurat e tenderimit pa publikim⁴⁶, me qëllim të furnizimit të reparteve të Hemodializës, me material shpenzues për trajtimin e pacientëve. Historikisht, për gati 20 vite, këto materiale ishin furnizuar nga një Operator Ekonomik i vetëm, nën arsyetimin se pajisjet e pranuar nga klinika si donacion nuk përkrahin materiale të tjera. Megjithatë, me datën 12 dhjetor 2017 një operator ekonomik, kishte parashtruar ankesë⁴⁷ në OSHP lidhur me procedurën e mbyllur, nën arsyetimin se në treg gjenden disa opsione të ndryshme të materialeve shpenzuese, me renome botërore, të cilat mund të shfrytëzohen për të njëjtin funksion. Në vendimin e OSHP, të datës 02 shkurt 2018⁴⁸, kërkohet nga Ministria e Shëndetësisë, që për shkak të urgjencës, ky të jetë tenderi i fundit me procedurë të mbyllur, derisa të zhvillohen procedurat e hapura.

b. HULUMTIMI I TREGUT

Vendimi i OSHP-së, i datës 02 shkurt 2018, është një nga bazat kryesore të hulumtimit të tregut, me ç’ rast pas këtij vendimi, ky tender është hapur për tregun. Për më shumë, sipas Dosjes së Tenderit(DT), MSH kishte hulumtuar tregun dhe profesionistët e lëmisë kishin konkluduar se ekziston një konkurrencë e gjerë për furnizimin në fjalë⁴⁹.

c. DOSJA E TENDERIT

Dosja e tenderit “Furnizim me material shpenzues për Hemodializë nga Lista Esenciale për FSSH”, me numër të prokurimit 206-18-2512-1-1-1, ishte përgatitur me datën 15 prill 2018 dhe përmbante kërkesën për furnizim si në vijim:

46 Tenderi me numër të prokurimit: 206/17/5226/115

47 OSHP, Ankesa me numër: 504/17 data 12 dhjetor 2017

48 Vendimi i OSHP-së, numër 504/17, i datës 02 shkurt 2018

49 Tenderi me numër të Prokurimit: 206-18-2512-1-1-1, Dosja e Tenderit, fq. 16: “Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar”: Arsyetimi: “Duke pas parasysh rendësin dhe ndjeshmërinë e këtyre artikujve të hemodializës, ka qenë e nevojshme që të bëhet një hulumtim paraprak në aspektin praktik të funksionimit të hemodializës si sektor me qëllim të gjetjes së zgjidhjes dhe mundësisë së konkurrencës sa me të gjere, ku është hulumtuar funksionimi në regjion nga profesionistët e lëmisë”.





#	Përshkrimi i kërkesës	Në Listën Esenciale të Barnave
LOT 1	Koncentrat pluhur i bikarbonatit në qese 650gr Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S ose Koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit 8.4% Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S	PO
LOT 2	Koncentrat pluhur acidik (dry acid concentrates) Composition of ready to use dialysis fluid, Nam- mol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=2 Glucose-1gr/L Acetati mmol/L=3-6 (të sigurohen kanistra për një përdorim prej 5 litër) Ose Koncentrat i lëngshëm acidik me permbajtje si ne vijim: Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=2 Glucose-1gr/L Acetati mmol/L=3-6	PO JO
LOT 3	Koncentrat pluhur acidik (dry acid concentrates) Composition of ready to use dialysis fluid Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=3 Glucose-0 gr/L Acetati mmol/L=3-6 (të sigurohen kanistra për një përdorim prej 5 litër) Ose Koncentrat i lëngshëm acidik, me përmbajtje si në vijim: Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=3 Glucose-0gr/LAcetati mmol/L=3-6	PO JO
LOT 4	Linjat A-V kompatible me aparturen. Diametri i dhomezës venoze 18-22mm, Segmenti i pompës me diametër 8mm dhe gjatësi mbi 32 cm Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S.	PO
LOT 5	Filter i fluidit polysulfone, kompatibel me apartin (endotoxine retention capacity > 1.000.000, effective surface area 2.2 m2	PO
LOT 6	Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me bazë të acidit citrik 20% Paketim maksimal 10L (dezinfektim i nxehtë) ose Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me bazë të acidit peracetik me hidrogjen peroksid me përqendrim maksimal 4%, paketim maksimal 5L (dezinfektim i ftohtë) Ose Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me të natrium hipokloridit 10%, me paketim maksimal 10L (dezinfektim i ftohtë).	PO



|||||

Dosja e Tenderit përbëhej prej tre pjesëve si në vijim:

Pjesa A: Procedurat e tenderimit që përmbajnë udhëzime për përgatitjen e tenderit;

Pjesa B: Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe

Pjesa C: Formulari i Tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit

Vlera e përgjithshme e tenderit ishte 2,119,898.00€, për kontratë me kohëzgjatje 12 mujore, dhe ishte ndarë në gjashtë Lot-e si në vijim:

#	Vlera e Parashikuar EURO
LOT 1	€ 682,528.00
LOT 2	€ 359,424.00
LOT 3	€ 39,936.00
LOT 4	€ 780,000.00
LOT 5	€ 180,000.00
LOT 6	€ 78,000.00
Vlera e parashikuar	€ 2,119,888.00

Nën arsyetimin e afateve për furnizim⁵⁰, afati i rregullt prej 40 ditësh është zvogëluar në 20 ditë për dorëzimin/pranimin e ofertave.



Ministria e Shëndetësisë kishte kërkuar sigurimin e tenderit për 120 muaj në shuma si në vijim.

Lot 1 20,000.00 €	Lot 2 10,000.00 €	Lot 3 1,000.00 €
Lot 4 20,000.00 €	Lot 5 5,000.00 €	Lot 6 2,000.00 €

⁵⁰ Tenderi me numër të Prokurimit: 206-18-2512-1-1-1, Dosja e Tenderit, fq. 16; "Afati kohor për dorëzimin është shkurtuar": Përgjigja PO, Arsyetimi: "OE potencial e njohin këtë lami dhe paraprakisht janë te përgatitur për këtë aktivitet duke marre parasysht procedimin paraprak qe është bere dhe meqenëse për AK është me shumë rëndësi kontraktimi sa me pare i materialit te domosdoshëm, shkurtimi i afatit kohor për tenderim ne 20 dite është mjaft i arsyeshëm dhe nuk e kufizon konkurrencën".

|||||

|||||

Sasitë indikative për periudhën 12 mujore ishin:

Nr. Lot	Emertimi me specifikim	Doza/Njësia	Sasia orientuese vjetore Niveli Sekondar/Terciar Mosperputhja e lejuar +/- 30%
LOT 1	- Koncentrat pluhur i bikarbonatit ne qese 650gr Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S. ose	650 g	156,000 cope
	- Koncentrat i lengshem i bikarbonatit 8.4% ne Kanistra Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S.	kanister	780,000 litra
LOT 2	- Koncentrat pluhur acidic (dry acid concentrates) Composition of ready to use dialysis fluid Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=2 Glucoze-1gr/L Acetati mmol/L=3-6 (te sigurohen kanistra për një përdorim prej 5 litër) ose	litres of conc/box 100	702,000 litra
	- Koncentrat i lengshem acidic me permbajtje si ne vijim: Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=2 Glucoze-1gr/L Acetati mmol/L=3-6	kanister	702,000 litra
LOT 3	- Koncentrat pluhur acidic (dry acid concentrates) Composition of ready to use dialysis fluid Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=3 Glucoze-0 gr/L Acetati mmol/L=3-6 (te sigurohen kanistra për një përdorim prej 5 litër) ose	litres of conc/box	78,000 litra
	- Koncentrat i lengshem acidic, me permbajtje si ne vijim: Na mmol/L=138-140 Ca mmol/L=1.25-1.50 Kmmol/L=3 Glucoze-0gr/L Acetati mmol/L=3-6	100 kanister	78,000 litra
LOT 4	- Linjat A-V kompatible me aparturen. Diametri i dhomezes venoze 18-22mm, Segmenti i pompës me diametër 8mm dhe gjatësi mbi 32 cm Kompatibil me aparaturën ekzistuese 4008S.	cope	156,000 cope
LOT 5	- Filter i fluidit polysulfone, kompatible me apartin (endotox- ine retention capacity > 1.000.000, effective surface area 2.2 m2	cope	1,500 cope
LOT 6	- Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me bazë të acidit citrik 20% paketim maksimal 10L (dezinfektim i nxehhtë) ose	kanistra	15,600 litra
	- Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me bazë të acidit peracetik me hidrogjen peroksid me përqendrim maksimal 4%, paketim maksimal 5L (dezinfektim i ftohtë) ose	kanistra	15,600 litra
	- Tretësirë dezinfektuese për aparat të hemodializës me të natrium hipokloridit 10%, me paketim maksimal 10L (dezin- fektim i ftohtë).	kanistra	15,600 litra

|||||

dhe Lot 6, me pretendimin se MSH kishte shkëlur ligjin e Prokurimit Publik⁵⁴, respektivisht Nenet 7⁵⁵, 27⁵⁶, 59⁵⁷, 66⁵⁸, 69⁵⁹ dhe 108⁶⁰ dhe kishte përzgjedhur fitues një OE të papërgjegjshëm.

Të njëjtit Operator Ekonomik ishin ankuar edhe në shkallën e parë, respektivisht në Ministrinë e Shëndetësisë, e cila pas shqyrtimit të ankesave, i kishte cilësuar ato si të pa bazuara. Në njërin prej vendimeve (me Nr. 05-6796, të datës 18.10.2018), MSH kishte refuzuar si të pa bazuar ankesën e OE i cili pretendonte se OE i rekomanduar për kontratë nga MSH nuk kishte plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit(DT) sa i përket aftësisë teknike dhe profesionale. Konkretisht ky OE në ankesën e tij pretendonte se produktet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë nuk janë produkte me specifika si janë kërkuar në DT. Arsyeimi i MSH-së për refuzim të kësaj ankese ndër të tjera ishte se edhe në kontratën paraprake janë furnizuar nga i njëjti OE me të njëjtat paisje, të cilat janë përdorur në Qendrat e Hemodializës dhe kanë funksionuar në mënyrë të rregullt⁶¹. MSH në këtë rast i'u ka referuar Kontratës Emergjente që ishte dhënë gjatë kohës kur ankesat për procesin e rregullt ishin duke u shqyrtuar në OSHP. Pas vendimit të MSH, dy OE kanë deponuar ankesa në OSHP, vendimet⁶² e së cilës janë publikuar më datë 23 nëntor 2018. Sipas vendimit të dytë më datën 23 nëntor 2018, OSHP⁶³ ka marr një vendim për dy ankesa të OE (të datës 19.10.2018 dhe 29.10.2018), dhe i ka cilësuar pjesërisht si të bazuara, ku vendos që të mbetet në fuqi njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues. Pas këtij vendimi, MSH ka vazhduar me nënshkrimin e kontratës për llotet 1,2,3,4 dhe 6 me datën 13 dhjetor 2018. Kontrata për llot 5, nuk kishte pasur asnjë ankesë, dhe ishte nënshkruar me datën 31 tetor 2018.

Thyerja e monopolit i cili kishte zgjatur afër 20 vite, kishte rezultuar në kursimin e mesatarisht 80% të vlerës sa ishin paguar këto produkte paraprakisht, dhe çmimeve të kontratës së zhvilluar me procedurë të hapur.

LOT	Kontrata Nr. 5226	Sasia	Njësia	Çmimi për paketim	Kontrata Nr. 2512	Sasia	Njësia	Çmimi total	Diferenca në çmim	Diferenca %
1	Koncentrat pluhur i bikarbonati	60,940.00	650gr	€ 5.60	Koncentrat I lëngshëm I bikarbonatit	156,000	kanister 5L	€ 1.65	€ 3.95	70.54%
2&3	Koncentrat pluhur Acidik	2,520.00	gr	€ 65.00	Koncentrat I lëngshëm Acidik	156,000	kanister 5L	€ 1.70	€ 63.30	97.38%
4	Linjat A-V	59,750.00	copë	€5.00	Linjat A-V	156,000	copë	€ 2.09	€ 2.91	58.20%
6	Tretësirë Dezinfektuese	1,358	litër	€25.00	Tretësirë Dezinfektuese	15,600	litër	€ 2.05	€ 22.95	91.80%

54 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (<https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>)

55 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 7 Barazja në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

56 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 27 Dosja e Tenderit

57 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

58 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale

59 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

60 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 108 Konfidencialiteti

61 Vendimi dates 18.10.2018 me Nr. 05-6796, (e-Prokurimi, Dosja e Tenderit me numër të prokurimit:260-18-2512-1-1-1)

62 Vendimi Nr. 348/18, Vendimi Nr. 581/18,606/18 (<https://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>)

63 Numri i vendimit 581/18,606/18 | disponueshëm në: <file:///C:/Users/Asus/OneDrive%20-%20Transparency%20International/Desktop/Ankesat%20dhe%20vendimet%20Hemodializes/581-606-18vend%20perfundimtare.pdf>



KONTRATA ME PROCEDURË TË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË ME NUMËR TË PROKURIMIT 206-18-6370-115

1. FAZA PARATENDERUESE

Në njoftimin dërguar KRPP-së nga Ministria e Shëndetësisë sqarohen arsyet e përdorimit të procedurave tenderuese të mbyllura, sipas të cilit vonesat në shqyrtimin e ankesave nga OSHP, respektivisht nënshkrimi i kontratave me procedurë të rregullt për Lot-et 1,2,3,4,5 dhe 6 për Furnizim me material shpenzues medicinal për Hemodializë⁶⁴ kishin rrezikuar mbetjen e reparteve të Hemodializës pa këto produkte, rrjedhimisht shërbimet vitale për pacientët që trajtohen në Hemodializë. Prandaj me qëllim të përmbushjes së nevojave urgjente është inicuar procedura e prokurimit me negociim.

MSH me datë 31 gusht 2018 kishte inicuar tenderin për **Furnizim emergjent me material shpenzues medicinal për Hemodializë nga Lista Esenciale e Barnave** për FSSH (Fondi për Sigurime Shëndetësore) me nr. Prokurimi **206-18-6370-1-1-5**, sipas procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë. Tenderi ishte i ndarë sipas produkteve që planifikohej të furnizoheshin, në tre Lot-e (Lot 1-Koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit, Lot 2- Koncentrat i lëngshëm acidik dhe Lot 3- Linjat A-V).

Në mungesë të stoqeve të mjaftueshme nëpër barnatoret e spitaleve të përgjithshme, MSH ishte detyruar të përdor këtë procedurë, e cila sipas Ligjit të Prokurimit Publik⁶⁵ aplikohet për rastet e emergjencave ekstreme. Sipas LPP, emergjenca ekstreme duhet të përdoret në rastet kur situata nuk mund të parashikohet.

Afatet ligjore për zhvillimin e procedurave të prokurimit parashohin afërsisht 168 ditë prej shpalljes, adresimin e ankesave dhe vendimeve para tenderuese dhe tenderuese, deri te dhënia e kontratës.

64 Njoftim për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik i datës 27 gusht 2018

65 Neni 35.2.1 lliii) i Ligjit për Prokurimin Publik



Kalendari i përafërt⁶⁶:

Faza	Përshkrimi	Njësia (ditë)
Njoftimi për kontratë	Afati për ofertim (procedura e përsheptuar)	20
	Ankesa në AK për DT	5
	Vendimi i AK	5
	Ankesa në OSHP	10
	Vendimi i OSHP	34
Njoftimi për dhënie të kontratës	Fillimi i procesit të vlerësimit pas hapjes së ofertave	5
	Afati për Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve	30
	Kërkesa për dokumentacion shtesë	5
	Ankesa në AK për dhënje të kontratës	5
	Vendimi i AK	5
	Ankesa në OSHP	10
	Vendimi i OSHP	34
Totali i përafërt		168

Për të evituar nevojën e shfrytëzimit të procedurës emergjente, MSH në të ardhmen do të duhej të planifikonte fillimin e procedurave tenderuese së paku në përputhje me afatet e më sipërme (6 muaj para skadimit të kontratës). Në rastin konkret, edhe sikur procedura e hapur e tenderimit të kishte filluar menjëherë pas vendimit të OSHP-së të datës 02 shkurt 2018, prapë, në rrezik të ankesave dhe shqyrtimeve, nuk do të ishte një kohë e mjaftueshme për dhënien e kontratës së re para skadimit të kontratës ekzistuese.

2. TENDERIMI

Sipas rregulloreve të LPP-së⁶⁷, gjatë përzgjedhjes së OE për dhënie të kontratës në rastet kur procedura e hapur nuk mund të përdoret, dhe kur procedura e negociuar është e domosdoshme, AK duhet të sigurohet se është zhvilluar proces konkurses, të marrë numër optimal të ofertave nga sa më shumë OE që të jetë e mundur. AK duhet të hulumtoj tregun për furnizuesit potencial dhe të lidhë kontrata me çmime të cilat nuk duhet të jenë më të larta se çmimet e tregut. Para përcaktimit të operatorit ekonomik për dhënie të kontratës, AK duhet të ftojë për negociim OE të cilët ofrojnë këto furnizime më qëllim që të sigurohen çmime të njejta me çmimet e tregut. MSH nuk kishte vepruar sipas këtyre udhëzimeve duke ftuar për negociim vetëm një OE për të tre Lot-et, dhe duke mos shfrytëzuar konkurrencën e tregut dhe duke eliminuar mundësinë e sigurimit të çmimeve më të volitshme.

⁶⁶ Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

⁶⁷ Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Pika 52.6



3. VLERËSIMI DHE DHËNIA E KONTRATËS

MSH me datën 3 shtator 2018 kishte vendosur që për të tre Lot-et të shpërblejë me kontratë një Operator Ekonomik të vetëm për këto tre Lot-e, në vlerë totale 284,040.00€.

Në kohën e dhënies së kësaj kontrate me procedura emergjente, për shkak të vonesave si rezultat i ankesave në OSHP, MSH si bazë negociimi kishte marrë çmimet nga kontrata ekzistuese me numër të prokurimit 206-17-5226-115, e datës 20 dhjetor 2017. Meqë, ofertat e pranuar në përgjigje të procedurës së hapur nuk ishin hapur deri më datën 07 shtator 2018, nga dokumentet e pranuar nga MSH, KDI nuk ka arritur të dëshmojë njohurinë e MSH-së lidhur me kapacitetet realizuese dhe kualifikimet e një OE të ri në furnizimin me produktet e sipërcekura, dhe arsyet për përjashtimin e OE të tjerë nga kjo procedurë emergjente.

Pa marrë parasysh sfidat e mësipërme, kjo kontratë, për shkak të iniciativave për thyerjen e monopolit në furnizim me material shpenzues për Hemodializë, qytetarit i ka kursyer mesatarisht 7% të çmimeve për njësi të paguara historikisht për koncentrat të bikarbonatit dhe linjat A-V, dhe rreth 95% për furnizim me koncentrat acidik.

Kontrata Nr. 5226	Sasia	Njësia (doza)	çmimi për paketim	Kontrata Nr. 6370	Sasia	Njësia (doza)	çmimi për paketim	Diferenca në çmim	%
Koncentrat pluhur i bikarbonati	60,940	650gr	5.60€	Koncentrat I lengshem I bikarbonatit	780,000	Kanister 5L	5.10€	0.5€	9%
Koncentrat pluhur Acidik	2520	gr	65.00€	Koncentrat I lengshem Acidik	780,000	Kanister 5L	3.30€	61.7€	95%
Linjat A-V	59,750	copë	5.00€	Linjat A-V	156,000	copë	4.80€	0.2€	4%

Në mesin e tre Lot-eve të tenderuara për këtë kontratë, MSH është furnizuar edhe me produktin **Koncentrat i lëngshëm acidik**, i cili nuk është pjesë e Listës Esenciale të Barnave. Vlera totale e kontraktuar e këtij produkti është 62,700.00 Euro.

Në vazhdim, edhe pse tenderi ishte i ndarë në tre Lot-e, këto Lot-e ishin përfshirë si tre komponent të një kontrate të vetme, ku sipas legjislacionit për rregullimin e prokurimit publik, vlera e tërësishme e të gjitha Lot-eve është vlera e parashikuar e kontratës⁶⁸. Duke u bazuar në këtë përkufizim ligjor, sipas të njëjtit legjislacion, Ministria e Shëndetësisë nuk është dashur të trajtoj vlerën e kontratës si vlerë të ndarë sipas parashikimeve për Lot⁶⁹; me ç’rast kjo kontratë është dashur të nënshkruhet edhe nga Zyrtari Kryesor Administrativ⁷⁰, i autorizuar për nënshkrimin e kontratave të vlerës së madhe⁷¹, dhe jo vetëm nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit⁷².

68 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.9: Nëse aktiviteti i prokurimit ndahet në disa lote, dhe secila i nënshtrohet kontratës së veçantë, vlera e tërësishme e parashikuar për të gjitha lotet e tilla do të jetë "vlera e parashikuar e kontratës".

69 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.4..." Sidoqoftë, ndarja në lote nuk nënkupton ndarjen e vlerës së kontratës ose shmangien nga pragjet e vlerave, pasi që përbëhet nga vlera e përbashkët e loteve".

70 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 9. Funksionet e Zyrtarit Kryesor Administrativ; paragrafi 9.1.h. *Për të nënshkruar kontratat me vlerë të madhe (nga kjo përgjegjësi përjashtohet Presidenti, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri si dhe Ministri i Financave kur Qeveria ose Ministria e Financave cakton AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të prokurimit konform nenit 95 të LPP-se);*

71 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, Neni 13 Parashikimi i vlerës dhe klasifikimi i kontratës; 13.14 Pragjet e vendosura për aktivitete të ndryshme të prokurimit janë si në vijim: Nga tabela: Furnizim – Vlerë e madhe ≥ 125,000 €. Vlera e përgjithshme e kontratës 206-18-6370-115 është 284,040.00€ €.

72 Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 26, paragrafi 2: "përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit të përmendur në paragrafin 1. të këtij neni, kontratat me vlera të mëdha(mbi 125.000 mijë euro) të autoriteteve kontraktuese duhet që gjithashtu të nënshkruhen në emër të autoritetit kontraktues nga Zyrtari Kryesor Administrativ, si dhe Ministri ose autoriteti tjetër përkatës publik.





KONTRATA ME PROCEDURË TË NEGOCIUAR PA PUBLIKIM TË NJOFTIMIT PËR KONTRATË ME NUMËR PROKURIMI 206-18-8748-115

1. FAZA PARATENDERUESE

Njëjtë sikurse edhe kontrata paraprake, edhe kjo kishte lindur si nevojë e furnizimit emergjent të shkaktuar nga vonesa në dhënien e kontratës me procedurë të hapur⁷³.

2. TENDERIMI

Për dallim nga kontrata emergjente paraprake me numër 206-18-6370-115, për kontratën e dytë, MSH u kishte dërguar kërkesë për ofertë gjashtë kompanive. Nga këto kompani vetëm OE performues në kontratën paraprake kishte dorëzuar ofertë. Gjatë intervistave të KDI-së me OE, të mbajtura me datën 29 nëntor dhe 7 dhjetor 2018, OE-të ishin deklaruar se afati për ofertim ishte shumë i shkurtër (më pak se 4 orë pune), për produkte që nuk janë të konsumit të gjerë.

3. VLERËSIMI DHE DHËNIA E KONTRATËS

Ministria e Shëndetësisë kishte lidhur edhe një kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë me numër të prokurimit 206-18-8748-115. Kjo kontratë ishte nënshkruar me datë 12 nëntor 2018 në vlerë prej 104,607.00 Euro. Edhe në këtë rast Ministria e Shëndetësisë kishte shpërblyer me kontratë OE performues të kontratës emergjente paraprake.

Edhe pse çmimet e kontraktuara në këtë kontratë ishin afërsisht 55% më të larta se ato të ofertuara nga po i njëjti OE në procedurën e hapur (e që i atribuohen sasive dhe afateve të dorëzimit), këto çmime ishin më të ulëta se kontrata paraprake emergjente për afërsisht 12%.

⁷³ Kontrata me numër të prokurimit: 206-18-2512-1-1-1



|||||

1. Krahasimi me çmimet për të njëjtat produkte nga kontrata me numër të prokurimit

206-18-2512-1-1-1, me procedurë të hapur:

Përshkrimi	Çmimi i kontratës së dytë të negociuar	Çmimi i kontratës me procedurë të hapur	Diferenca në çmim	Diferenca në vlerë
Koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit	0.9	0.33	0.57	63%
Linjat A-V	4.2	2.09	2.11	50%

2. Krahasimi me çmimet për të njëjtat produkte nga kontrata me numër të prokurimit

206-18-6370-115, me procedurë të negociuar pa publikim:

Përshkrimi	Çmimi i kontratës së parë të negociuar	Çmimi i kontratës së dytë të negociuar	Diferenca në çmim	Diferenca në vlerë
Koncentrat i lëngshëm i bikarbonatit	1.02€	0.9€	0.12€	12%
Linjat A-V	4.8€	4.2€	0.6€	13%

|||||



KONKLUZIONET

- Duke thyer monopolin pothuajse 20 vjeçar të furnizimit me material shpenzues për Hemodializë, MSH kishte kursyer afërsisht 80% të çmimit që ishte paguar paraprakisht për 5 nga 6 Lot-et e tenderuara.
- Nënshkrimi i kontratave për furnizim me material shpenzues për Hemodializë është vonuar mbi 8 muaj nga data e publikimit të njoftimit për kontratë si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomik. Duke pasur parasysh afatet ligjore për secilën procedurë duke përfshirë ankesat, MSH nuk kishte filluar procesin e tenderimit në kohë të mjaftueshme për të evituar nevojat emergjente.
- Në kontratën e parë emergjente me numër të prokurimit 206-18-6370-115, Ministria e Shëndetësisë nuk kishte shfrytëzuar të gjitha dispozitat e lejuara me ligj për të rritur konkurrencën dhe për të siguruar çmim sa më të mirë duke stimuluar konkurrencën në treg, por duke lidhur kontratë direkte me një Operator Ekonomik.
- Çmimet e kontraktuara në kontratën e parë emergjente, me numër të prokurimit 206-18-6370-115, ishin rreth 12% më të larta se çmimet e kontratës vijuese emergjente, me numër të prokurimit 206-18-8748-115, me të njëjtin Operator Ekonomik, për sasi më të vogla dhe afate të dorëzimit të përafërta.
- Në kontratën e parë emergjente me numër të prokurimit 206-18-6370-115, vlera e përgjithshme e të cilës ishte 284,040.00€, ishte nënshkruar vetëm nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.
- Tek kontrata e dytë emergjente, MSH kishte siguruar çmim më të mirë të produkteve, si dhe kishte ftuar për pjesëmarrje 6 operator ekonomik. Megjithatë, koha për përgjigje ishte shumë e shkurtër, e cila kishte rezultuar në ofertimin vetëm nga OE performues i kontratës së parë emergjente me numër të prokurimit 206-18-6370-115.
- Pas analizimit dhe krahasimit me kontratën e dhënë në bazë të tenderimit me procedurë të hapur, KDI ka vërejtur se çmimet e kontraktuara në kontratën emergjente ishin deri në 209% më të larta se çmimet me të cilat kishte ofertuar OE i njëjtë, që na bënë të kuptojmë rëndësinë e konkurrencës së hapur duke pasur parasysh mungesën e sinqeritetit afarist në zhvillimin e procedurave të mbyllura.





REKOMANDIME

- Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurohet që procedurat e prokurimit të inicohen në kohë të mjaftueshme për të parashikuar përmbushjen e të gjitha afateve të përcaktuara me ligj të prokurimit publik, me qëllim të shmangies së përdorimit të procedurave të negociuara.
- Ministria e Shëndetësisë të bëjë një analizë të tregut për të gjitha blerjet një burimore, të t'u siguruar që nuk kemi të bëjmë me një situatë të ngjashme monopoli, sikurse ajo e deritanishme për furnizimin me material shpenzues për Hemodializë.
- Gjatë përdorimit të procedurave të negociuara, KDI rekomandon që Ministria e Shëndetësisë të veprojë në përputhje me Rregullat dhe Udhëzimet Operative të Prokurimit Publik. Sipas rregulloreve të LPP-së, gjatë përzgjedhjes së OE për dhënie të kontratës në rastet kur procedura e hapur nuk mund të përdoret, dhe kur procedura e negociuar është e domosdoshme, AK duhet të sigurohet se është zhvilluar proces konkurrues, të marr numër optimal të ofertave nga sa më shumë OE që të jetë e mundur.
- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik të inicoj procedurat për plotësim të legjislacionit aktual për të kategorizuar dhe definuar afatet e shqyrtimit të ankesave nga OSHP në bazë të prioriteteve.
- OSHP të prioritetizojë trajtimin e ankesave që burojnë nga tenderët që lidhen me furnizimin e barnave dhe materialeve me rëndësi jetike për shëndetin e qytetarëve.



|||||

|||||

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.
Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



British Embassy
Pristina